

## 5.2 FORMATI MARC

Shfaqja në formatin MARC mundëson kontrollin e regjistrimit në formën e fushave dhe nënfushave të formatit COMARC/B.

Të dhënat për regjistrimet nga fusha e sistemit ndodhen në fillim, pastaj vijon fusha me nënfushat dhe treguesit.

Nga fusha e sistemit shfaqen këto të dhëna (nëse ekzistojnë):

- numri identifikues i regjistrimit ("ID")
- numri lokal i regjistrimit ("LN")
- lloji e maskës
- varianti i regjistrimit
- data e krijimit të regjistrimit dhe emri i personit, i cili e ka krijuar atë
- data e fundit e ndryshimit dhe emri i personit, i cili e ka ndryshuar regjistrimin ("Updated")
- data e fundit e shkarkimit nga COBIB-i dhe emri i personit i cili e ka shkarkuar regjistrimin ("Copied")
- data e shkarkimit të parë nga COBIB-i ("First Copied")
- data e ruajtjes së regjistrimit në COBIB ("SaveToHost")
- data e konfirmimit të tipologjisë dhe emri i personit, i cili e ka konfirmuar tipologjinë ("TD Confirmed")
- data e sinkronizimit të fundit automatik të regjistrimeve bibliografike me bazat e njësuar të të dhënave CONOR dhe SGC ("SynToCon")
- data e shkarkimit të regjistrimit nga rrjeti COBISS.Net dhe emri i personit, i cili e ka shkarkuar regjistrimin ("COBISS.Net")
- data e shënimit të fundit të të dhënave për koleksionet në modulën COBISS3/Koleksionet dhe emri i personit, i cili i ka shënuar këto të dhëna ("COBISS3")
- shenja që tregon se regjistrimi ka qenë në modulën COBISS2/Katalogimi ("KAT2")



### Shembull:

Në paraqitës kontrollohet regjistrimi me numër identifikues 1168. Nga fusha e sistemit shfaqen të dhënat për regjistrimin:

**ID=1536062960 LN=0000000025 M V3 05.07.2012 BASH::OLD Updated:**  
**15.04.2013 EDUAL1::ARJETA Copied: 22.01.2008 IZUM::TANJA First**  
**Copied: 15.04.2013**

Tek shfaqja e regjistrimit përdoren këto ngjyra:

- **e kuqja** për numrat e fushave
- **e zeza** për vlerat numerike të treguesve dhe përmbajtjen e nënfushave
- **e gjelbra** për shenjat e nënfushave
- **blu** për shenjat e elementeve
- **vjollce** për përmbajtjen brenda nënfushës *996/997f – Numri i inventarit*

Nëse me regjistrimin e përzgjedhur janë të lidhura regjistrimet ose objektet e tjera, ato shfaqen në pjesën e dritares **Objektet e lidhura**.